R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9920, DATË 19.5.2008, "PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", synon forcimin e kuadrit procedural dhe të masave administrative, në funksion të përmbushjes së detyrimeve tatimore, rritjes së efektivitetit të administrimit tatimor dhe kufizimit të mundësive për mospërmbushje të detyrimeve, të përcaktuara në legjislacionin tatimor.

Në mënyrë të veçantë, ndërhyrjet e propozuara lidhen me forcimin e disiplinës së pagesës së parapagimeve, zbatimin e kufizimeve për pagesat dhe arkëtimet me para në dorë, përmirësimin e procedurës së kontrollit, në kuadër të çregjistrimit të subjekteve, si dhe garantimin e paraqitjes në kohë të dokumentacionit të transferimit të çmimit.

Në këtë kuadër, objektivat kryesorë, që synohen të arrihen, janë:

- forcimi i përmbushjes së detyrimeve tatimore, përfshirë parapagimet;
- reduktimi i mundësive për mospërmbushje dhe abuzim me detyrimet për parapagimet;
- forcimi i zbatimit të kufizimeve ligjore për pagesat dhe arkëtimet me para në dorë;
- rritja e efektivitetit të kontrollit dhe verifikimit të situatës tatimore në procesin e çregjistrimit;
- forcimi i respektimit të detyrimeve për paraqitjen në afat të dokumentacionit të transferimit të çmimit;
- rritja e qartësisë dhe sigurisë juridike në zbatimin e masave administrative;
- garantimi i bashkëpunimit të tatimpaguesve dhe sigurimit të informacionit gjatë procedurave të kontrollit e hetimit tatimor.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është parashikuar në programin analitik të projektakteve.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ndryshimet dhe shtesat e propozuara në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, synojnë përmirësimin e kuadrit ligjor të procedurave tatimore dhe forcimin e mekanizmave që mbështesin përmbushjen e detyrimeve tatimore, duke adresuar njëkohësisht çështje të evidentuara në zbatimin e dispozitave në fuqi.

1. Përfshirja e parapagimeve në kompetencat e administratës tatimore për mbledhjen me forcë.

Parapagimet sipas nenit 63 "Parapagimet" të ligjit nr.29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", përbëjnë një element të rëndësishëm të përmbushjes së detyrimeve tatimore gjatë periudhës tatimore dhe, në kushtet e rënies së nivelit të pagesave të tyre, është e nevojshme të forcohen mekanizmat që mbështesin respektimin në kohë të këtij detyrimi. Përfshirja e parapagimeve shprehimisht në kompetencat e administratës tatimore për të zbatuar procedurat e mbledhjes me forcë, nëpërmjet ndryshimit të nenit 88, pika 1, krijon një bazë të qartë ligjore për zbatimin e dispozitave të kreut XI të ligjit, duke kufizuar mundësitë për mospërmbushje dhe abuzim. Duke i siguruar administratës tatimore të drejtën për zbatimin e procedurave të mbledhjes me forcë për këto detyrime tatimore, krijohen kushte më të përshtatshme për administrimin e tyre dhe për sigurimin e të ardhurave që lidhen me to.

Propozimi për t'i mundësuar administratës tatimore zbatimin e të gjitha procedurave të parashikuara në ligj për mbledhjen me forcë të parapagimeve, sipas nenit 63 të ligjit për tatimin mbi të ardhurat (kësteve paraprake të tatimit mbi fitimin korporativ dhe tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi), të papaguara në afat, pas përfundimit të afatit ligjor të pagesës, synon të garantojë administrimin dhe mbledhjen në afat të këtyre detyrimeve përgjatë vitit.

Me ndryshimet e bëra në vitin 2023, mospagesa e kësteve të tatimit mbi fitimin korporativ dhe mbi të ardhurat personale, e cila trajtohet sipas nenit 114/1 "Mospagimi në afat i kësteve paraprake të tatimit mbi fitimin korporativ dhe tatimit mbi të ardhurat personale", parashikon se mospagesa e parapagimeve nga biznesi dhe vetëpunësimi, sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat,

dënohet me gjobë në masën 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë kalendarike.

Ulja e masës administrative nga 10% në 0.06% ka përbërë një ndër faktorët që kanë ndikuar në uljen e disiplinës së pagesës së parapagimeve nga tatimpaguesit. Megjithatë, për të mos rritur masën administrative, propozimi përcakton vetëm të drejtën e administratës tatimore për mbledhjen e tyre me forcë, duke nxitur shlyerjen e parapagimeve në përputhje me afatet e pagesës së kësteve, sipas nenit 63 të ligjit për tatim mbi të ardhurat. Ky propozim shmang akumulimin e një vlere të konsiderueshme detyrimi për t'u paguar në momentin e deklarimit dhe përcaktimit përfundimtar të detyrimit tatimor, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës. Në këtë mënyrë, zbatimi i dispozitave shtrënguese pas maturimit të kësteve, i jep administratës tatimore instrumentet e duhura për ndërmarrjen në kohë të masave për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara.

2. Përmirësimi i procedurës së kontrollit në kuadër të çregjistrimit të subjekteve/tatimpaguesve.

Shtesa e bërë në pikën 3.3, të nenit 45, lidhet me kontrollin që administrata tatimore mund të kryejë, bazuar në analizën e riskut, në mjedisin ku subjekti ushtron veprimtarinë, gjatë procedurës së çregjistrimit. Ky kontroll shërben për verifikimin e situatës tatimore të subjektit përpara përfundimit të procesit të çregjistrimit dhe, për këtë arsye, kërkohet një procedurë që mundëson kryerjen e verifikimit brenda afateve të përcaktuara për këtë proces.

Përcaktimi se, për këtë kontroll, nuk zbatohet afati i njoftimit të parashikuar në nenin 81 "Njoftimi i kontrollit tatimor", të këtij ligji, qartëson raportin ndërmjet dispozitave dhe mundëson kryerjen në kohë të verifikimit të nevojshëm, pa cenuar kufirin maksimal prej 30 ditësh pune, të përcaktuar në nenin 45, për ushtrimin dhe pasqyrimin e kontrollit në situatën tatimore të subjektit. Në këtë mënyrë, shmangen vonesat procedurale dhe sigurohet një vlerësim më efektiv i situatës tatimore përpara përfundimit të procesit të çregjistrimit. Përjashtimi nga afati i njoftimit nuk cenon garancitë procedurale të kontrollit. Ai prek vetëm momentin e njoftimit, ndërsa kontrolli dhe rezultatet e tij vazhdojnë të dokumentohen dhe të trajtohen sipas rregullave përkatëse, brenda afatit të përcaktuar në nenin 45.

3. Forcimi i kuadrit ligjor për kufizimin e pagesave dhe arkëtimeve me para në dorë.

Vitin e kaluar, me paketën fiskale 2026, u bënë ndërhyrje në nenin 59 të ligjit për procedurat tatimore, ku u rrit kufizimi në shuma maksimale për kryerjen e

transaksioneve me para në dorë mes bizneseve, si dhe u parashikuan edhe kufizime për transaksionet mes bizneseve dhe individëve. Nga zbatimi në praktikë ka rezultuar e nevojshme që dispozita që përcakton masën administrative në nenin 120 të ligjit, kur nuk zbatohet ky detyrim, të jetë në përputhje me fushën dhe përmbajtjen e detyrimit ligjor, si për transaksionet midis bizneseve, ashtu edhe për transaksionet mes bizneseve dhe individëve. Në këtë mënyrë, sigurohet një lidhje e qartë ndërmjet normës që përcakton detyrimin dhe normës që parashikon pasojën administrative në rast të mosrespektimit të tij.

Në këtë kuadër, fillimisht përcaktohet ndryshimi i titullit të nenit 120, duke zëvendësuar formulimin "Pagesat ose arkëtimet me para në dorë mbi 150 000 lekë" me formulimin "Pagesat ose arkëtimet me para në dorë mbi kufijtë e lejuar". Ndryshimi i emërtimit është i nevojshëm për ta përshtatur titullin e dispozitës me përmbajtjen e saj dhe me rregullimin e parashikuar në nenin 59.

Aktualisht, paragrafi i parë i nenit 120 përcakton masë administrative vetëm për rastet e transaksioneve mes tatimpaguesve dhe terminologjia e përdorur i referohet ligjit të vjetër për tatimin mbi të ardhurat. Konkretisht, përmbajtja e këtij paragrafi është:

"*Tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, që kryejnë ndërmjet tyre transaksione shitjeje apo blerjeje me para në dorë, jo në përputhje me përcaktimin e pikës 1, të nenit 59, të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën 10 për qind të vlerës së secilit transaksion*.

Ndryshimi konsiston në riformulimin e këtij paragrafi, me qëllim rregullimin e terminologjisë sipas ligjit nr.29/2023, për sa i përket kategorive të tatimpaguesve, si dhe shtrirjen e zbatimit të masës administrative prej 10% të vlerës së secilit transaksion edhe për rastet e pagesave cash mes tatimpaguesve dhe konsumatorëve (pika 3, e nenit 59).

Në përfundim, nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje synohet të sigurohet koherenca e kuadrit ligjor për kufizimin e transaksioneve me para në dorë, duke lidhur në mënyrë të qartë kufizimet e përcaktuara në nenin 59 me masat administrative të parashikuara në nenin 120. Kjo qasje mbështet zbatimin efektiv të kufizimeve, rrit gjurmueshmërinë e transaksioneve dhe kontribuon në forcimin e formalizimit të veprimtarisë ekonomike.

4. Përcaktimi i masës administrative për mosparaqitjen në afat të dokumentacionit të transferimit të çmimit.

Shtimi i pikës 3 në nenin 126 lidhet me nevojën për të forcuar respektimin e detyrimit për paraqitjen e dokumentacionit të transferimit të çmimit brenda afatit

të përcaktuar në ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat". Ky dokumentacion i nevojitet administratës tatimore për administrimin dhe verifikimin e informacionit që lidhet me zbatimin e rregullave të transferimit të çmimit. Për këtë arsye, parashikimi i një mase administrative të posaçme për mosparaqitjen e tij brenda afatit krijon një mekanizëm më të qartë për garantimin e përmbushjes së këtij detyrimi.

Përcaktimi i gjobës në masën 100 000 lekë synon të sigurojë respektimin e afatit ligjor dhe të rrisë efektivitetin e detyrimit për dhënien e informacionit të nevojshëm për administratën tatimore. Ky ndryshim plotëson kuadrin ekzistues të sanksioneve dhe krijon një trajtim të posaçëm për një detyrim me rëndësi për administrimin dhe kontrollin e transaksioneve ndërmjet palëve të lidhura.

Ndryshimi synon të plotësojë kuadrin sanksionues lidhur me detyrimin e tatimpaguesit për vënien në dispozicion të administratës tatimore të dokumentacionit të transferimit të çmimit, brenda afatit 45-ditor, të përcaktuar në nenin 37, pika 1, të ligjit nr.29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.

Ky detyrim ndryshon nga detyrimi për paraqitjen e "Njoftimit të transaksioneve vjetore të kontrolluara", për mosparaqitjen në kohë të të cilit neni 115/1, pika 1, i ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, parashikon sanksion të posaçëm. Dokumentacioni i transferimit të çmimit vihet në dispozicion të administratës tatimore vetëm me kërkesë të saj dhe brenda afatit të përcaktuar në ligj.

Nga praktika e strukturave të kontrollit tatimor është evidentuar se sanksioni i parashikuar në nenin 126, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, për refuzimin e dhënies së informacionit të kërkuar nga administrata tatimore, nuk mund të zbatohet për rastin e mosvënies në dispozicion të dokumentacionit të transferimit të çmimit brenda afatit të përcaktuar në nenin 37, pika 1, të ligjit nr.29/2023. Për këtë arsye, parashikimi i një sanksioni të posaçëm synon të sigurojë zbatimin efektiv të këtij detyrimi dhe të plotësojë kuadrin e masave administrative në fushën e transferimit të çmimit.

5. Forcimi i masave ndaj refuzimit të përsëritur për dhënien e informacionit tatimor.

Ndryshimet e propozuara në nenet 126 dhe 127 të ligjit synojnë të garantojnë përmbushjen e detyrimit të tatimpaguesve për të dhënë informacionin e kërkuar nga administrata tatimore, në përputhje me dispozitat e legjislacionit tatimor, si dhe të sigurojnë efektivitetin e ushtrimit të kompetencave të saj gjatë procedurave të kontrollit dhe hetimit tatimor.

Informacioni i kërkuar nga administrata tatimore është i nevojshëm për verifikimin e të dhënave të tatimpaguesve, vlerësimin e situatës së tyre ekonomike-financiare dhe kontrollin e përmbushjes së detyrimeve tatimore. Refuzimi për dhënien e këtij informacioni mund të pengojë ose të vështirësojë kryerjen e verifikimeve dhe procedurave të nevojshme nga administrata tatimore.

Për këtë arsye, propozohet plotësimi i nenit 126, me pikën 2, e cila parashikon se, kur tatimpaguesi, pasi është dënuar për mosdhënien e informacionit të kërkuar, refuzon ta japë atë edhe pas përsëritjes së kërkesës, ndaj tij zbatohen dispozitat e nenit 127 të ligjit. Kjo ndërhyrje synon të krijojë një lidhje të qartë ndërmjet mosdhënies së informacionit dhe pasojave që sjell vijimi i këtij refuzimi, duke nxitur përmbushjen e detyrimit për bashkëpunim me administratën tatimore.

Në vijim, propozohet shtesa në pikën 3 të nenit 127, me qëllim përfshirjen shprehimisht të rastit kur tatimpaguesi, pasi është dënuar sipas nenit 126, refuzon të japë informacionin e kërkuar edhe pas përsëritjes së kërkesës. Në këtë mënyrë, refuzimi i përsëritur merret në konsideratë në kuadër të ushtrimit të kompetencave të organeve tatimore për sigurimin e dokumentacionit dhe të mjeteve të nevojshme për verifikimin e gjendjes ekonomike-financiare të tatimpaguesit, sipas kushteve të parashikuara në këtë dispozitë.

Ndryshimet synojnë të forcojnë bashkëpunimin e tatimpaguesve me administratën tatimore, të lehtësojnë sigurimin e informacionit të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të saj dhe të rrisin efektivitetin e procedurave të kontrollit dhe hetimit tatimor, duke përcaktuar pasoja të qarta për rastet kur detyrimi për dhënien e informacionit nuk përmbushet edhe pas përsëritjes së kërkesës.

Në tërësi, ndryshimet e propozuara synojnë të përmirësojnë koherencën dhe zbatueshmërinë e kuadrit ligjor të procedurave tatimore, duke forcuar disiplinën në përmbushjen e detyrimeve, qartësuar procedurat e kontrollit dhe të sanksionimit si dhe duke rritur efektivitetin e instrumenteve në dispozicion të administratës tatimore. Efektet e pritshme lidhen me rritjen e përmbushjes në kohë të detyrimeve tatimore, përfshirë parapagimet, forcimin e gjurmueshmërisë së transaksioneve, përmirësimin e kontrollit tatimor dhe mbështetjen e procesit të formalizimit të ekonomisë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës dhe është në përputhje me përcaktimet e normave kushtetuese nga

pikëpamja substanciale, si dhe është në harmoni me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nuk synon përafrimin me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj përbëhet nga 6 nene.

Neni 1 i projektligjit parashikon përjashtimin nga afati i njoftimit për kontrollin e parashikuar në nenin 45, pika 3.3, të ligjit në fuqi, duke përcaktuar se për këtë kontroll nuk zbatohet afati i njoftimit të parashikuar në nenin 81 të ligjit.

Ndryshimi synon të mundësojë kryerjen në kohë të verifikimit të situatës tatimore, duke respektuar afatin maksimal prej 30 ditësh punë të përcaktuar për këtë procedurë.

Neni 2 i projektligjit parashikon që në pikën 1, të nenit 88, të ligjit në fuqi, pas fjalëve "... detyrimet tatimore të papaguara, ..." të shtohen "... përfshirë parapagimet sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat, ...", duke i dhënë kompetencë të qartë administratës tatimore që të zbatojë procedurat e mbledhjes me forcë edhe për parapagimet e papaguara, sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat.

Neni 3 i projektligjit parashikon ndryshimin e nenit 120 të ligjit në fuqi, duke filluar me ndryshimin e titullit të tij, nga "Pagesat ose arkëtimet me para në dorë mbi 150 000 lekë" në "Pagesat ose arkëtimet me para në dorë mbi kufijtë e lejuar". Ky ndryshim synon përshtatjen e titullit të dispozitës me kufizimet e përcaktuara në nenin 59 të ligjit.

Gjithashtu, ndryshohet paragrafi i parë i nenit 120, duke përcaktuar se tatimpaguesit, personat fizikë, individët tregtarë, të vetëpunësuarit apo entitetet, të cilët kryejnë transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë në kundërshtim me kufizimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 3 të nenit 59, i nënshtrohen masës administrative të parashikuar në këtë dispozitë.

Neni 4 i projektligjit propozon dy rregullime në nenin 126 të ligjit në fuqi. Së pari, shtohet pika 2, ku parashikohet se në rast refuzimi të përsëritur për dhënien

e informacionit nga tatimpaguesi, ndaj tij zbatohen masat e nenit 127. Së dyti, shtohet pika 3, ku përcaktohet masa administrative me gjobë 100 000 lekë për mosparaqitjen në afat të dokumentacionit të transferimit të çmimit. Kjo synon të sigurojë respektimin e afatit të përcaktuar në ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat" dhe përmbushjen e detyrimit për paraqitjen e këtij dokumentacioni.

Neni 5 i projektligjit propozon ndryshimin e pikës 3, të nenit 127, të ligjit në fuqi, duke i dhënë të drejtë administratës tatimore të sekuestrojë dokumentacionin dhe pajisjet kompjuterike e fiskale të tatimpaguesit kur ky i fundit refuzon në mënyrë të përsëritur dhënien e informacionit, edhe pasi është dënuar më parë sipas nenit 126.

Neni 6 përcakton hyrjen në fuqi të ligjit, 15 ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare".

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Disa nga ndryshimet e propozuara do të sjellin efekte pozitive në buxhetin e shtetit, por që nuk mund ta maten se lidhen me sjelljen e tatimpaguesit.

Vendosja e masës administrative prej 10% të vlerës së faturës, në rast se konstatohet se është kaluar limiti cash prej 500 mijë lekësh në transaksionet biznes-konsumator, do të ndikojë në deklarimin real të shitjeve nga bizneset dhe rrjedhimisht në formalizimin e ekonomisë.

Mundësimi i mbledhjes me forcë të parapagimeve, sipas nenit 63, të ligjit për tatimin mbi të ardhurat, do të ndikojë pozitivisht në të ardhurat nga tatimi në vitin korrent, sepse do të rrisë pagesat nga tatimpaguesit.

KËSHILLI I MINISTRAVE